



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.66/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afijete Sada Gllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Ilir Culaj nga Franca, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datën 06 tetor 2019 në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**PRANOHET si i bazuar** apeli Anr. 66/2019 i Ilir Culaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës, **URDHËROHET** KQZ-ja të përfshijë votuesin Ilir Culaj, në listat e votuesve jashtë Kosovës.

## A r s y e t i m

Me datën 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Ilir Culaj, në të cilën pretendon se kërkesën e tij për votim jashtë Kosovës KQZ-ja e ka refuzuar gabimisht pa asnjë arsye, për vërtetimin e këtyre pretendimeve parashtruesi i ka bashkangjitur ankesës: kopjen e letërnjoftimit të Kosovës, formularin e aplikacionit për votim jashtë Kosovës.

Në përgjigjen në apel të datës 21.09.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se Ilir Culaj ka dërguar aplikacion për regjistrim gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim dhe me kopje të dokumenteve valide me të cilat plotëson kushtet për t'u përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës.

PZAP-i pas që shqyrtoj apelin vlerësoj se:

### **Apeli është i bazuar**

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i bazuar pasi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ne përgjigjen e saj thekson se parashtruesi ka dërguar aplikacion për regjistrim gjate periudhës se aplikimit për regjistrim dhe me kopje te dokumenteve valide me te cilat plotëson kushtet për t'u përfshirë ne listën e votuesve jashtë Kosovës. Prandaj paneli, ka konstatuar se apeli ka mbështetje ligjore në nenin 3.1, pika a), e Rregullës Zgjedhore nr.03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“Votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedhë fletëvotimin për zgjedhjet në bazë të procedurave që përcaktohen me këtë rregull të zgjedhjeve”*, pasi që në rastin konkret parashtruesi i apelit posedon dokumente valide të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës dhe njëherit i plotëson kriteret për të qenë pjesë e Listës së Votuesve.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 3, 118 par. 1, 122 par. 1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par. 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 66/2019 më datën 22.09.2019.

**Kryesuesi i Panelit**

**Faton Adem**



#### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*